

Ndihmesa për leximin në familje

Ju si prindër mund ta mbështesni më së miri zhvillimin e gjuhës dhe leximit të fëmijës tuaj.



Të eksplorosh shkrimin së bashku

Shenjat e shkrimit dhe simbolet e mahnitin fëmijën tuaj. Me ndihmën tuaj ai mund të zbulojë sekretet e shkrimit në rrugën e duhur. Letra dhe lapsat e ftojnë atë për eksperimentim.



Të shkojmë në bibliotekë

Librat mund të bëhen shokë të ngushtë.

Në bibliotekë ju së bashku me fëmijën tuaj mund të huazoni libra për në shtëpi.



Të përkrahurit e shumë gjuhëve

Fëmija juaj mund të mësojë njëkohësisht fare mirë dy apo tre gjuhë. Por këtu duhen rregulla të qarta, se kur cila gjuhë duhet folur kur.



Krijim kontaktesh

Mos u shqetësoni: në kontakt me fëmijët e tjerë dhe të rriturit, fëmija juaj e mëson shpejt gjermanishten. Mundësojini ju atij kontakte te tilla si p.sh.: në grupe loje (Spielgruppe) ose në çerdhe.



Të folurit në gjuhën amëtare

Nëse ju flisni me fëmijën tuaj në atë gjuhë që ju e zotëroni më mirë, i jepni kështu atij një bazë të sigurtë për mësimin e gjuhëve të tjera.



Dëgjoni dhe jepni përgjigje

Fëmija juaj e zhvillon gjuhën e tij nëpërmjet bisedës me ju. Nëse ju flisni me të për vëzhgimet e tij, ai e zgjeron fjalorin e tij dhe kështu i lind dëshira për të zbuluar gjëra të reja.



Kënaqesia e përbashkët për gjuhën

Me gjuhën mund të luhet më së miri. Nëpërmjet vjershave, këngëve dhe lojërave me lëvizje fëmija juaj e përjeton atë në mënyrë shumë zbavitëse.



Të tregosh përralla dhe të shikosh figura

Tregimet dhe figurat i hapin fëmijës tuaj botë të reja.

Ai mund t'i eksplorojë ato së bashku me ju dhe të njohë shumë terma të reja.



Projektet për përkrahjen e gjuhës dhe të leximit

SIKJM-i mbështet projektet për përkrahjen gjuhësore dhe aftësive literale të fëmijëve të vegjël dhe fëmijëve parashkollor.

Buchstart, një projekt i realizuar me bashkëpunimin e Bibliomedia Schweiz i dhuron cdo foshnjeje të lindur në Zvicërr librin e parë. Bibliotekat ftojnë prindërit më fëmijët e tyre të vegjël për të lozur me rima vjershash dhe përrallash.

Në kornizën **Më dhuro një përrallë – Family Literacy** takohen prindër-fëmijë të gjuhëve të ndryshme në grupe nën drejtimin e nje animatoreje për të treguar tregime, për tu argëtuar me këngë e vargje, duke parë libra me figura për të eksploruar botën e të shkruarit. Për më tepër SIKJM-i ofron specializimet e **mëposhtme**:

- ursin «Leseanimatorin SIKJIM – Literale Förderung im Frühbereich».
- specializime për animatoret «Schenk mir eine Geschichte» dhe për animatoret interkulturore.

Për më shumë info: www.sikjm.ch – Literale Förderung



**Schweizerisches Institut
für Kinder- und Jugendmedien SIKJM**

Georgengasse 6, 8006 Zürich

Tel. 043 268 39 00

info@sikjm.ch, www.sikjm.ch